

## K O N V E N T E

Midis Republikes Popullore te Shqiperise  
dhe Bashkimit te Republikave Socialiste  
Sovjetike mbi dhenien e ndihmes juridike  
per çeshtje civile, familjare, marteses  
dhe penale

Presidiumi i Kuvendit Popullor i Republikes Popullore te Shqiperise dhe Presidiumi i Sovjetit Suprem te Bashkimit te Republikave Socialiste Sovjetike, te udhehequr nga deshira e perbashket per te forcuar dhe zhvilluar edhe ne te arthmen lidhjet vellazerore midis popullit te Republikes Popullore te Shqiperise dhe popujve te Bashkimit te Republikave Socialiste Sovjetike dhe, duke i dhene nje rendesi te madhe bashkepunimit ne fushen e marredhenieve juridike, vendosen te lidhin Konventen mbi dhenien e ndihmes juridike per çeshtje civile, familjare, te marteses dhe penale dhe, per kete qellim, emeruan si te Plotfuqishem te tyre :

Presidiumi i Kuvendit Popullor te Republikes Popullore te Shqiperise, Nesti Nase Ambasador i Jashtezakoneshem dhe Fuqiplote i R.P.SH. ne B.R.S.S.,

Presidiumi i Sovjetit Suprem te Bashkimit te Republikave Socialiste Sovjetike, Nikollaj Pavlloviç Firiubin Zevendes Minister i Puneve te Jashteme te B.R.S.S.,

te cilet pas shkembimit te Plotfuqishmerise te tyre, qe u gjenden ne formen e duhur dhe te plote, u muaren vesh per sa vijon :

### PJESA I

#### DISPOZITA TE PERGJITHESHME

##### Neni 1

##### Mbrojtja juridike

1.- Shtetasit dhe personat juridike ( qe me tutje do te quhen "shtetas" ) te nje Pale Kontraktonjese gezojne ne teritorin e

Pales tjeter kontraktonjese, persa u perket te drejtave te tyre personale dhe pasurore, po ate mbrojtje juridike si dhe shtetasit dhe personat e tyre juridike.

2.- Ata kane te drejte t'u drejtohen lirisht dhe pa pengese gjykatave, prokurorise, zyrave noteriale ( qe me tutje do te quhen " institucione te drejtesise ") dhe institucioneve te tjera te Pales tjeter Kontraktonjese, ne kopetencen e te cilave hyjne çeshtjet civile, familjare, te marteses dhe penale, te marrin pjese ne 'to, si dhe t'u drejtojne kerkesa dhe te ngrejne padi po ne ato kushte si dhe shtetasit e Pales tjeter Kontraktonjese.

#### Neni 2

##### Dhenia e ndihmes juridike

1.- Institucionet e drejtesise te te dy Paleve Kontraktonjese u japin ndihme juridike njeri tjetrit per çeshtje civile, familjare, te marteses dhe penale.

2.- Institucionet e drejtesise u japin ndihme juridike edhe institucioneve te tjera per çeshtjet qe permenden ne piken 1 te ketij neni.

#### Neni 3

##### Menyra e komunikimit

Ne dhenien e ndihmes juridike, institucionet e drejtesise te Paleve Kontraktonjese komunikojne midis tyre nepermjet organeve te tyre qendrore, pergjersa nuk parashikohet ndryshe nga kjo Konvente.

#### Neni 4

##### Vellimi i ndihmes juridike

Palet Kontraktonjese i japin ndihme juridike njera tjetres me ane te kryerjes se veprimeve te veçanta proceduriale; ne veçanesi me ane te perpilimit dhe dergimit te dokumentave, te kryerjes se

kqyrjeve, perjashtimeve, te dergimit dhe dorezimit te provave materiale, te kryerjes se ekspertimeve, te pyetjes se te pandehurve, deshmitareve, eksperteve, te pyetjes se paleve dhe te personave te tjere, te kqyrjes drejt per drejt nga Gjykata, si dhe me ane te dorezimit te dokumentave.

#### Neni 5

##### Forma e dokumentave

1.- Dokumentat e derguara nga institucionet e drejtesise dhe institucionet e tjera ( qe me tutje do te quhen "institucione"), ne lidhje me dhenien e ndihmes juridike, duhet te kene vule.

2.- Kur palet Kontraktonjese kerkojne qe t'u jepet ndihme, perdorin formulare ne dy gjuhet, modelet e te cileve ato ia njoftojne njera tjetres.

#### Neni 6

##### Forma e porosise per dhenie ndihme juridike

1.- Porosia per dhenie ndihme juridike duhet te permbaje kete rekuizite :

- a) emertimin e institucionit qe ben porosine;
- b) emertimin e institucionit te drejtesise te cilit i drejtohet porosia;
- c) emertimin e ceshtjes per te cilen kerkohet dhenia e ndihmes juridike;
- ç) emrat dhe mbiemrat e paleve, te te pandehurve, te te denuarve, shtetesine e tyre, profesionin dhe vendbanimin ose vendqendrimin e perhereshem te tyre;
- d) emrat dhe mbiemrat dhe adresat e perfaqesuesave te tyre;
- dh) permbajtjen e porosise, si dhe njoftimet e nevojshme mbi thelbin e porosise, dhe, per ceshtjet penale, edhe pershkrimin e figures se krimit.

2.- Ne porosine per dorezim dokumentash, duhet te tregohet,

perveç ketyre, edhe adresa e sakte e pritesit si dhe emertimi i dokumentit që dorëzohet.

## Neni 7

### Menyra e kryerjes së porosise

1.- Në kryerjen e porosise për dhënie ndihme juridike, institucioni i drejtesise, të cilit i është drejtuar porosia, zbaton legjislacionin e shtetit të tij. Por, me kërkesë të institucionit që bën porosinë, ai mund të zbatojë normat proceduriale të Pales Kontraktgjese që bën porosinë, nëqoftesë ato nuk vijnë në kundërshtim me legjislacionin e shtetit të tij.

2.- Kur institucioni i drejtesise, të cilit i është drejtuar porosia, nuk është kompetent për t'a kryer, ai dërgon porosinë institucionit kompetent të drejtesise, duke njoftuar për këtë institucionin që ka bërë porosinë.

3.- Kur mer kërkesën përkatëse, institucioni i drejtesise, të cilit i është drejtuar porosia, njofton institucionin që ka bërë porosinë për kohën dhe vendin e kryerjes së porosise.

4.- Pas kryerjes së porosise, institucioni i drejtesise, të cilit i është dërguar porosia, i kthen dokumentat institucionit që ka bërë porosinë, në këtë rast, nëqoftesë ndihma juridike nuk ka qenë e mundur të jepet, ai njofton me një herë për rrethanat të cilat pengojnë për kryerjen e porosise.

## Neni 8

### Paprekshmeria e deshmitareve dhe e ekspertëve

1.- Deshmitari ose eksperti, që me ftese të dërguar institucionit të drejtesise të Pales Kontraktgjese, se ciles i është drejtuar porosia, paraqitet në institucionin e Pales Kontraktgjese që ka bërë porosinë, nuk mund të merret, pavarësisht nga shtetësia e tij, në përgjegjësi penale, ose të ndalet, ose të vuajë në teri-

torin e saj denim penal per krim te kryer para se te kalonte kufirin e saj shteteror.

2.- Deshmitari ose eksperti e humbet kete garanci ne qoftese, me gjithë mundesine qe ka, nuk le teritorin e Pales Kontraktonejese, qe ka bere porosine, brenda nje jave nga dita kur institucioni i drejtesise qe e ka pyetur i njofton se prania e metejshme e tij nuk eshte e nevojshme. Ne kete afat nuk llogaritet koha gjate se ciles deshmitari ose eksperti, pa fajin e tij, nuk ka mundur te lere teritorin e Pales Kontraktonejese, qe ka bere porosine.

## Neni 9

### Porosia per dorezim dokumentash

1.- Institucioni i drejtesise, te cilit i eshte drejtuar porosia, ben dorezimin e dokumentave ne perputhje me menyren e caktuar nga shteti i tij per dorezimin e tyre, ne qoftese dokumentat qe dorezohen jane te shkruara ne gjuhen e tij ose te pajisura me perkthim te vertetuar. Ne rast te kunderte, ai dergon dokumentat pritesit kur ky pranon vullnetarisht t'i marre.

2.- Vertetimin e perkthimit e ben perkthyesi ose institucioni perkates, qe ka bere porosine, ose perfaqesuesi diplomatik ose konsullor i njeres nga Palet Kontraktonejese.

3.- Kur dokumentat nuk mund te dorezohen ne adresen qe tregohet ne porosine, institucioni i drejtesise, te cilit i eshte bere porosia, merr, me, inisiativen e tij, masat e nevojeshme per te gjetur adresen. Kur gjetja e adreses nga institucioni i drejtesise, te cilit i eshte bere porosia, eshte e pa mundur, ai njofton per kete institucionin qe ka bere porosine dhe i kthen ketij dokumentat qe duhej te dorezoheshin.

## Neni 10

### Lejimi i dorezimit te dokumentave

Lejimi i dorezimit te dokumentave, behet ne perputhje me

dispozitat mbi dorezimin e dokumentave, qe jane ne fuqi ne shtetin e institucionit te cilit i eshte drejtuar porosia.

#### Neni 11

##### Dorezimi i dokumentave shtetasve te vet

Te dy Palet Kontraktonjese kane te drejte t'u dorezojne dokumentat shtetasve te tyre nepermjet institucioneve te tyre diplomatike ose konsullore.

#### Neni 12

##### Vertetimi i dokumentave

1.- Dokumentat e perpiluara ose te vertetuara ne teritorin e njeres nga Palet Kontraktonjese prej gjykates ose nje personi zyrtar (perkthyes, i eperhereshem, ekspert, etj.), brenda kompetencave te tyre dhe ne formen e caktuar, dhe qe jane pajisur me vule me steme, pranchen ne teritorin e Pales Kontraktonjese pa ndonje vertetim tjeter.

2.- Dokumentat, te cilat ne teritorin e njeres nga Palet Kontraktonjese quhen si dokumenta zyrtare, kane fuqine provuese te dokumentave zyrtare edhe ne teritorin e Pales tjeter Kontraktonjese.

#### Neni 13

##### Shpenzimet ne lidhje me dhenien e ndihmes juridike

1.- Pala Kontraktonjese, se ciles i eshte drejtuar porosia, nuk do te kerkoje t'i paguhen kurrfare shpenzime per dhenie ndihme juridike. Shpenzimet e bera per dhenie ndihme juridike ne teritorin e tyre rendojne mbi vete Palet Kontraktonjese.

2.- Institucioni i drejtesise, te cilit i eshte drejtuar porosia, i njofton institucionit qe ka bere porosine shumen e shpenzimeve. Ne qofte se institucioni, qe ka bere porosine, i kerkon keto shpenzime nga personi i detyruar me to, shumet e kerkuara kalojne ne

dobi te Pales Kontraktonjese qe i ka kerkuar.

Neni 14

Njoftime per çeshtje te legjislacionit

Komisioni juridik prane Ministrise se Drejtesise se Republikes Popullore te Shqiperise dhe Keshillit te Ministrave te BRSS i japin njera tjetres, me kerkesen e tyre, njoftime per legjislacionin qeshte ose ka gene ne fuqi ne shtetin e tyre.

Neni 15

G j u h a

Institucionet e drejtesise te Paleve Kontraktonjese, ne komunikimet e tyre ne lidhje me çeshtjet e dhenies se ndihmes juridike perdorin gjuhen shqipe ose ruse :

Pjesa II

PJESA E POSACME

Kapitulli

I

MBROJTJA JURIDIKE PER CESHTJE CIVILE FAMILJARE  
DHE TE MARTESES SHPENZIMET GJYQESORE

Çkarkimi nga sigurimi i shpenzimeve gjyqesore.

Neni 16

Shtetasve te nje Pale Kontraktonjese, qe marrin pjese ne gjykatat e Pales tjeter Kontraktonjese dhe ndodhen ne teritorin e njeres nga Palet Kontraktonjese, nuk duhet t'u ngarkohet detyrimi per te siguruar shpenzimet gjyqesore vetem per shkak se ata jane te huaj, ose nuk kane vend banimi, vend qendrimi ose vend te perhereshem te ndodhjes.

Neni 17

1.- Neqoftese shtetasve, te çkarkuar nga sigurimi i shpen-

zimeve gjyqesore sipas nenit 16te kesaj Konvente, u ka gene ngarkuar ne teritorin e nje Pale Kontraktonjese, detyrimi per te paguar shpenzime gjyqesore, gjykata perkatese ne teritorin e Pales tjeter Kontraktonjese vendos, ne baze te kerkeses pa shperblim, per nxjerrjen e detyruar te ketyre shpenzimeve.

2.- Ne shpenzimet gjyqesore perfshihen edhe shpenzimet ne lidhje me perpilimin e dokumentave, perkthimin dhe vertetimin e dokumentave qe permenden ne nenin 18 te kesaj Konvente.

#### Neni 18

1.- Gjykata qe ka lejuar ekzekutimin e detyrueshem te vendimit mbi nxjerrjen e shpenzimeve gjyqesore, kufizohet ne kontrollin ne se vendimi ka marre formen e prere dhe ne se i neneshtrohet ekzekutimit.

2.- Kerkeses per te lejuar ekzekutimin e detyrueshem i bashkangjitet kopja e vendimit mbi shpenzimet, e vertetuar nga gjykata e shkalles se pare, dhe shenimi i bere nga po kjo gjykate se vendimi ka marre formen e prere dhe i neneshtrohet ekzekutimit.

3.- Vendimi i gjykates mbi lejimin e ekzekutimit te detyrueshem mund te kunderrshtohet ne perputhje me legjislacionin qe eshte ne fuqi ne teritorin e gjykates qe ka dhene vendimin.

4.- Dokumentat qe permenden ne piken 2 te ketij neni duhet te bashkangjiten te perkthyerat dhe ne forme sipas pikes 2 te nenit 9 te kesaj Konvente ne gjuhen e Pales Kontraktonjese, ne teritorin e se ciles duhet te behet ekzekutimi i detyrueshem.

#### Neni 19

Kerkesa per lejimin e ekzekutimit te detyrueshem qe duhet te behet ne teritorin e Pales tjeter Kontraktonjese, i dergohet gjykates qe ka dhene vendimin mbi shpenzimet, ose gjykates qe ka dhene vendimin per ceshtjen ne shkalle te pare. Kjo gjykate ia percjell kerkesen gjykates kompetente te Pales tjeter Kontraktonjese, ne menyren e parashikuar nga neni 3 i kesaj Konvente.



## Neni 20

Shpenzimet per perpilimin e dokumentave, te perkthimit dhe vertetimit te dokumentave, qe permenden ne nenin 18 te kesaj Konvente, caktohen nga gjykata qe ka shqyrtuar çeshtjen ne shkalle te pare, ose nga gjykata qe eshte kompetente per te lejuar ekzekutimin e detyrueshem. Gjykata, qe eshte kompetente per te lejuar ekzekutimin e detyrueshem, cakton edhe shpenzimet qe kane lidhje me ekzekutimin e detyrueshem.

## Çkarkimi nga taksat dhe garancite gjyqesore

## Neni 21

Shtetasit e nje Pale Kontraktonjese çkarkon, ne teritorin e Pales tjeter Kontraktonjese, nga taksat dhe garancite po ne ato kushte dhe po ne ate vellim qe çkarkohen edhe shtetasit e saj.

## Neni 22

1.- Dokumentin per gjendjen personale dhe familjare, per pagen dhe pasurine e leshon institucioni kompetent i Pales Kontraktonjese, ne teritorin e se ciles ka vend banimin ose vend qendrimin personi qe ka bere kerkesen.

2.- Ne qoftese personi qe ka bere kerkesen nuk ka, ne teritorin e Pales Kontraktonjese, vend banimin ose vend qendrim te perhereshem, eshte i mjaftushem dokumenti qe leshon institucioni perkates diplomatik ose konsullor i shtetit te tij.

3. Institucioni i drejtesise qe, ne baze te kerkeses per çkarkim nga taksat dhe garancite, ka dhene vendim, mund te kerkoje te dhena plotesuese.

## Neni 23

1.- Shtetasi i nje Pale Kontraktonjese, qe desheron te beje

kerkese per t'u çkarkuar nga taksat dhe garancite para institucionit te drejtesise te Pales tjeter Kontraktonjese, mund t'ia beje kete kerkese me goje institucionit kompetent te drejtesise te vendit te banimit ose qendrimit te tij te perhereshem, i cili njoftimin e shenon me proçes verbal. Institucioni i drejtesise, kete proçes-verbal, se bashku me dokumentin sipas pikes 1 te nenit 22 te kesaj Konvente, dhe me dokumentat e tjera te paraqitura nga personi qe ka bere kerkesen, ia percjell institucionit te drejtesise te Pales tjeter Kontraktonjese.

2.- Njekohesisht me kerkesen per çkarkimin nga taksat dhe garancite gjyqesore, mund te behet, me goje, edhe kerkesa per ngritje padie ose te ndonje proçedimi tjeter, dhe kjo shenohet ne proçes-verbal.

#### STATUTI PERSONAL DHE E DREJTA FAMILJARE

##### Neni 24

##### Zotesia per te vepruar

Zotesia per te vepruar e nje personi percaktohet nga legjislacioni i Pales Kontraktonjese, shtetas i se ciles ai eshte.

##### Neni 25

Njohja e vendimeve per çeshtje ne lidhje me zgjidhjen e martesës dhe me deklarimin e martesës si te pavlefshme.

Vendimet, qe kane marre forme te prere, te gjykatave te nje Pale Kontraktonjese per çeshtje ne lidhje me zgjidhjen e martesës dhe me deklarimin e martesës si te pavlefshme ( te pa qene ) te shtetasve te Pales Kontraktonjese, do te njihen ne teritorin e Pales tjeter Kontraktonjese pa u bere ndonji gjykim tjeter, neqoftese gjer

ne kete çast, asnje gjykatë e Pales tjeter kontraktonjese nuk ka dhane po per kete çeshtje vendim qe te kete marre forme te prere.

Kjo dispozite zbatohet edhe per vendimet e dhena para hyrjes ne fuqi te kesaj konvente.

#### Kundershtimi dhe vertetimi i atesise

##### Neni 26

Çeshtjet ne lidhje me kundershkrimin dhe vertetimin e atesise si dhe me percaktimin e lindjes se femijes nga nje martesë zgjidhen ne perputhje me legjislacionin e Pales Kontraktonjese, shtetas i te cilit eshte femija me lindjen.

##### Neni 27

Maredheniet juridike midis femijes se lindur nga persona ndermjet te cileve nuk ka martesë te lidhur rregullisht ( nenes se tij, nga njera ane, dhe atit, nga ana tjeter), percaktohen nga legjislacioni i Pales Kontraktonjese, shtetas i se ciles eshte femija.

##### Neni 28

Çeshtjet ne lidhje me kundershkrimin dhe vertetimin e atesise si dhe me percaktimin e lindjes se femijes nga nje martesë, jane ne kompetencen e gjykates se Pales Kontraktonjese, legjislacioni i seciles do te zbatohet sipas nenit 26 te kesaj Konvente.

Ne kete rast, ne qoftese paditesi dhe i padituri kane banimin e perhereshem ne teritorin e nje Pale Kontraktonjese, çeshtjet ne lidhje me vertetimin dhe kundershkrimin e atesise dhe me percaktimin e lindjes se femijes nga martesë jane ne kompetencen e gjykates edhe te kesaj Pale Kontraktonjese, me kusht qe te respektohet dispozita e nenit 26 te kesaj Konvente.

##### Neni 29

Deklarimi i çdukjes ose i vdekjes  
dhe konstatimi i faktit te vdekjes

1.- Per ceshtjet ne lidhje me deklarimin e çdukjes ose te vdekjes se nje personi, te konstatimit te faktit te vdekjes, kompetente jane institucionet e drejtesise te Pales Kontraktonjese shtetas i se ciles, sipas te dhenave te fundit, ka qene personi kur ishte gjalle.

2.- Institucionet e drejtesise te nje pale kontraktonjese mund te deklarojne te çdukur ose te vdekur shtetasin e Pales tjeter Kontraktonjese, si dhe te konstatojne faktin e vdekjes se tij me kerkesen e personave te interesuar, qe jetojne ne teritorin e saje, kur te drejtat dhe interesat e ketyre bazohen ne legjislacionin e kesaj Pale.

3.- Ne shqyrtimin e çeshtjeve per deklarimin e çdukjes ose te vdekjes, ose per konstatimin e faktit te vdekjes, institucionet e drejtesise te Paleve Kontraktonjese zbatojne legjislacionin e shtetit te tyre.

#### TUTORIA DHE KUJDESTARIA

##### Neni 30

1.- Per çeshtjet ne lidhje me tutorine dhe kujdestarine mbi persona te Paleve Kontraktonjese, kompetente, pergjersa nuk parashikohet ndryshe ne kete Konvente, jane institucionet e Pales Kontraktonjese shtetas i seciles eshte personi i ndodhur nene tutori ose kujdestari.

2.- Maredheniet juridike midis tutorit ose kujdestarit dhe personit te ndodhur nene tutori ose kujdestari percaktohen nga legjislacioni i Pales kontraktonjese, institucioni i seciles ka emruar tutorin ose kujdestarin.

3.- Per detyrimin e pranimit te tutorise ose te kujdestarise vepron legjislacioni i Pales Kontraktonjese, shtetas i seciles eshte tutori ose kujdestari.

## Neni 31

1.- Kur duhen marre masa ne lidhje me tutorine ose kujdestarine, te cilat jane te nevojshme per interesat e shtetasit te nje Pale Kontraktonjese, vend banimi, vend qendrimi i perhershem ose pasuri e te cilit ndodhet ne territorin e Pales tjeter Kontraktonjese, institucioni i kesaj Pale Kontraktonjese njofton sa me shpejt institucionin qe eshte kompetent sipas pikes 1 te nenit 30 te kesaj Konvente.

2.- Ne raste te nguteshme, institucioni i Pales tjeter Kontraktonjese mund te marre vete masa ne perputhje me legjislacionin e tij, por eshte i detyruar te njoftoje sa me shpejt institucionin qe eshte kompetent sipas pikes 1 te nenit 30 te kesaj Konvente. Keto masa qendrojne ne fuqi gjersa te vendoset ndryshe nga institucioni qe permendet ne piken 1 te nenit 30 te kesaj Konvente.

## Neni 32

1.- Institucioni, qe eshte kompetent sipas pikes 1 te nenit 30 te kesaj Konvente, mund t'i a kaloje tutorine ose kujdestarine institucionit te pales tjeter Kontraktonjese ne rast se personi, qe ndodhet nene tutori ose kujdestari, ka vend banim, vend qendrim te perhershem ose pasuri ne territorin e kesaj Pale Kontraktonjese. Kalimi i tutorise ose i kujdestarise hyn ne fuqi kur institucioni, te cilit i drejtohet porosia, pranon tutorine ose kujdestarine dhe njofton per kete institucionin qe ka bere porosine.

2.- Institucioni qe, sipas pikes 1 te ketij neni, pranon tutorine ose kujdestarine, vepron ne lidhje me keto sipas legjislacionit te shtetit te tij. Por, persa i perket ceshtjes se zotesise juridike ose zotesise per te vepruar, ai zbaton legjislacionin e Pales Kontraktonjese, shtetas i seciles eshte personi i ndodhur nene

tutorine ose kujdestarine. Ai nuk ka te drejte te jape vendime per ceshtje qe kane te bejne me statutjon e tije personal, por mund te jape leje per te lidhur martese, kur kjo eshte e nevojeshme sipas ligjes se Pales Kontraktonjese, shtetas i seciles eshte personi i ndodhur nene tutori ode kujdestari.

### Neni 33

#### Adoptimi

1.-Per adoptimin ose pushimin e tije zbatohet legjislacioni i Pales Kontraktonjese, shtetas i seciles eshte adoptuesi ne castin e adoptimit ose te pushimit te tij.

2.-Ne qoftese femija eshte shtetas i Pales tjeter Kontraktonjese, per adpotimin ose pushimin e tij duhet te merret leje nga kjo Pale Kontraktonjese.

3.-Ne qoftese femija adoptohet nga bashkshorti prej te cileve njeri eshte shtetas i nje Pale Kontraktonjese, dhe tjetri shtetas i Pales tjeter Kontraktonjese, adoptimi ose pushimi i tij duhet te behet ne perputhje me legjislacionin e te dy Paleve Kontraktonjese.

4.-Per ceshtjet ne lidhje me adoptimin ose pushimin e tij, kompetent eshte institucioni i Pales Kontraktonjese, shtetas i seciles eshte adoptuesi ne castin e adoptimit ose pushimit te tij. Ne rastin e parashikuar nga pika 3 e ketij neni, kompetent eshte institucioni i asaj Pale Kontraktonjese ne teritorin e se ciles bashkshortet kane ose kan patur vend banimin ose vend qendrimin e perbashket te perhereshem.

### Neni 34

Dergimi i dokumentave ne lidhje me aktet e gjendjes civile dhe te dokumentave te tjera

1.-Cdo Pale Kontraktonjese detyrohet t'i dergoje Pales tjeter Kontraktonjese, ne baze te kerkesave te bera ne udhe diplomatike, deshmi mbi regjistrimin e akteve te gjendjes civile, dokumenta mbi arsimin, mbi vjetersin ne pune dhe dekumenta te tjera qe kane te bejne me te drejtat dhe interesat personale te shtetasve te Pales tjeter Kontraktonjese.

2.-Keto dokumenta i dergohen Pales tjeter Kontraktonjese ne udhe diplomatike te pa perkthyer dhe pa shperblim.

#### TRASHEGIMIA

##### Neni 35

#### Parimi i barazise

Shtetasit e nje Pale kontraktonjese barazohen ne te drejtat me shtetasit e Pales tjeter Kontraktonjese, qe jetojne ne teritorin e saj, persa i perket zotesise per te bere dhe revokuar testament per pasuri qe ndodhen ne teritorin e Pales tjeter Kontraktonjese dhe te drejtave qe duhet te ushtrohen aty, si dhe persa i perket zotesise per te fituar me trashegim kete pasuri dhe keto te drejta. Pasurija dhe te drejtat kalojne te ai ne po ato kushte qe jane caktuar per shtetasin e vete Pale Kontraktonjese, qe jetojne ne teritorin e saj.

##### Neni 36

#### E drejta e trashegimise

1.-E drejta e trashegimise mbi nje pasuri te lujteshme rregullohet nga legjislacioni i asaj Pale Kontraktonjese, shtetas i seciles ka qene trashegimlenshi ne castin e vdekies se tij.

2.-E drejta e trashegimise mbi nje pasuri te palujteshme rregullohet nga legjislacioni i asaj Pale, ne teritorin e seciles ndodhet pasurija.

## Neni 37

## Testamenti

1.-Zotesija per te bere ose revokuar testament, si dhe pasojat juridike te te metave ne çfaqjen e vullnetit percaktohen nga legjislacioni i Pales Kontraktonjese, shtetas i seciles ka qe ne trashegimlensesi ne çastin e çfaqjes se vullnetit. Po nga ky legjislacion percaktohen edhe llojet e testamenteve qe lejohen.

2.-Forma e testamentit percaktohet nga legjislacioni i Pales Kontraktonjese, shtetas i seciles ka qe ne trashegimlensesi ne çastin e beries se testamentit, megjitheate, mjafton edhe te jete respektuar legjislacioni i Pales Kontraktonjese ne teritorin e seciles eshte bere testamenti. Kjo dispozite vlen edhe persa i perket revokimit te testamentit.

## Neni 38

## Kompetenca

1.-Ceshtjet ne lidhje me trashegimin e pasuris se lujteshme me perjashtim te rastit qe parashikohet ne piken 4 te ketij neni, shqyrtohen nga institucionet e drejtesise te Pales Kontraktonjese shtetas i seciles ka qe ne trashegimlensesi ne çastin e vdekjes.

2.-Ceshtjet ne lidhje me trashegimin e pasuris se pa lujteshme shqyrtohen nga institucionet e drejtesise te Pales Kontraktonjese, ne teritorin e seciles ndodhet kjo pasuri.

3.-Dispozitat e pikave 1 dhe 2 te ketij neni zbatohen, respektivisht, edhe ne konfliktet qe lindin ne baze te te drejtave trashegimore.

4.-Ne qoftese e gjithë pasurija e lujteshme trashegimore, qe ka mbetur pas vdekjes se shtetasit te nje Pale Kontraktonjese, ndodhet ne teritorin e Pales tjeter Kontraktonjese, edhe ne qoftese



jane te nje mendimi te gjithë trashëgimtaret, atehere me kerkesen e trashëgimtarit ose te personit ne dobi te te cilit esht lene legu, procedimi per ceshtjen ne lidhje me trashëgimin behet ne institucionetve drejtesise te saj Pale Kontraktonjese.

### Neni 39

#### Njoftimi per vdekjen

1.-Ne qoftese ne teritorin e nje Pale Kontraktonjese vdes nje shtetas i Pales tjeter Kontraktonjese, institucionit perkatese duhet te njoftoje per kete shpejt institucionin diplomatik ose konsullor te Pales tjeter Kontraktonjese dhe t'i behet e ditur atij gjithçka qe ai di per trashëgimtarët, vend banimin ose vend qendrimin e tyre, per masen dhe vleften e trashëgimis, si dhe nese ka testament. Kjo dispozite zbatohet edhe kur institucioni perkates i nje Pale Kontraktonjese merr njoftime se shtetasi i Pales tjeter Kontraktonjese, qe ka vdekur jasht territorit te te dy Paleve Kontraktonjese, ka lene pasuri ne teritorin e shtetit te tij.

2.- Neqoftese institucioni diplomatik ose konsullor merr njoftim per vdekjen me pare, ai eshte i detyruar te vere ne dijeni per kete institucionin e drejtesise qe eshte kompetent per marrjen e masave ne lidhje me ruajtjen e trashëgimise.

### Neni 40

#### Te drejtat e institucionit diplomatik ose konsullor ne procedimin trashëgimor

1.- Per te gjitha ceshtjet ne lidhje me trashëgimin qe lindin ne teritorin e njerës nga Palet Kontraktonjese, bashkepuntoret e institucionit diplomatik ose konsullor te Pales Tjeter Kontraktonjese kane te drejte te perfaqesojne ne institucionet e drejtesise

ose ne institucionet e tjera shtetasit e tyre, ne qoftese keta mungojne dhe nuk ia kane ngarkuar ceshtjen me prokure ndonje personi tjeter; ne raste te tilla, nuk kerkohet ndonje prokure e veçante.

2.- Neqoftese shtetasi i nje Pale Kontraktonjese vdes duke udhetuar ne territorin e Pales tjeter Kontraktonjese, ku ai nuk ka patur vend banim ose vend qendrim te perhereshem, sendet qe ai i kishte me vehte per perdorim personal, i jepen, pa kryer kurrfare veprimi, institucionit diplomatik ose konsullor te Pales Kontraktonjese, shtetas i seciles ai ishte.

#### Neni 41

##### Çelja e testamentit

Çelja dhe shpallja e testamentit hyn ne kompetencen e institucionit te drejtesise te Pales Kontraktonjese, ne territorin e seciles ndodhet testamenti. Kopja e vertetuar e testamentit dhe proçes-verbali mbi gjendjen dhe permbajtjen e testamentit dhe, sipas rrethanave, kopja e vertetuar e proçes-verbalit mbi shpalljen e testamentit si dhe, kur kerkohet, edhe origjinali i testamentit, i dergohen institucionit te drejtesise te shtetit te trashegimlensit ose institucionit te drejtesise te Pales Kontraktonjese ne te cilen behet proçedimi i ceshtjes.

#### Neni 42

##### Masat per sigurimin e ruajtjes se trashegimit

1.- Institucionet e te dy Paleve Kontraktonjese marrin, ne perputhje me legjislacionin e tyre, masat e nevojshme per te siguruar ruajtjen e treshegimit te lene ne territorin e tyre nga shtetasi i Pales tjeter Kontraktonjese, ose per administrimin e tij.

2.- Per masat e mara sipas pikes 1 te ketij neni, njoftohet sa me shpejt institucioni diplomatik ose konsullor i pales tje-

ter Kontraktonjese, i cili mund te marre pjese ne zbatimin e ketyre masave. Me propozimin e institucionit diplomatik ose konsullor masat e marra sipas pikes 1 te ketij neni, duhet te ndryshohen, te revokohen ose te pezullohen.

Me kerkese te institucionit diplomatik ose konsullor, ketij i dorzohet pasurija e lujteshme trashegimore dhe dokumentat e personit te vdekur.

#### Neni 43

##### Dorezimi i trashegimit

Neqoftese pas perfundimit te proçedimit trashegimor ne territorin e nje pale Kontraktonjese, per pasurine e lujteshme trashegimore ose shumat e nxjerra nga shitja e pasurise se lujteshme ose te palujteshema trashegimore dalin trashegimtare, vend banimi ose vend qendrimi i perhereshem i te cileve ndodhet ne territorin e Pales tjetre Kontraktonjese, pasurija trashegimore ose shumat e nxjerra nga shitja e saj i dorezohen institucionit diplomatik ose konsullor te kesaj Pale Kontraktonjese me kusht qe:

a) Zyra noteriale shteterore te kete thirur, kur nje gje e tille parashikohet nga legjislacioni i vendit ku ndodhet pasuria trashegimore, kreditorët e trashegimlensesit per te paraqitur, mbrenda tre muajve kerkesat e tyre;

b) Te gjitha taksat trashegimore dhe te gjitha kerkesat e paraqitura te jene siguruar ose paguar;

c) Institucionet perkatese te kene dhene pelqimin per daljen jasht shtetit te sendeve, qe perbejne trashegimin, ose per transferimin jasht shtetit te shumave te nxjerra nga shitja e tyre.

#### Neni 44

Njohja e fuqise ekzekutive te vendimeve per çeshtje civile, familjare dhe te martesës.

Te dy palet Kontraktonjese njohin se kane fuqi ekzekutive :

a) vendimet, qe kane marre forme te prere, te institucioneve te drejtesise per çeshtje civile, familjare dhe te marteses, si dhe vendimet e organeve te tutorise dhe te kujdestarise per çeshtje qe hyjne ne kompetencen e tyre, te dhene ne territorin e Pales tjeter Kontraktonjese per maredheneje juridike qe kane lindur pas hyrjes ne fuqi te kesaj Konvente.

b) vendimet gjyqesore penale qe kane marre formen e prere per çeshtje ne lidhje me shperblimin e demit te demtuarit.

Ekzekutimi i vendimeve gjyqesore per çeshtje civile, familjare dhe te marteses.

#### Neni 45

1;- Shqyrtimi i kerkesave per lejimin e ekzekutimit te detyrueshem hyn ne kompetencen e gjykatave te Pales Kontraktonjese, ne territorin e seciles duhet te behet ekzekutimi i detyrueshem.

2.- Kerkesa per lejimin e ekzekutimit te detyrueshem i paraqitet gjykates qe ka dhene vendimin mbi çeshtjen ne shkalle te pare. Kerkesa e paraqitur ne gjykatën qe ka dhene vendimin ne shkalle te pare, i perciellet gjykates qe eshte kompetente te vendose ne lidhje me kerkesen.

3.- Permbajtja e kerkeses percaktohet nga legjislacioni Pales Kontraktonjese, ne territorin e seciles duhet te behet ekzekutimi i detyrueshem.

4.- Kerkeses i bashkangjitet perkethimi ne gjuhen e Pales Kontraktonjese seciles i drejtohet kerkesa; perkethimi vertetohet sipas pikes 2 te nenit 9 te kesaj Konvente

#### Neni 46

Kerkeses per lejimin e ekzekutimit te detyrueshem duhet

t'i bashkangjiten:

a) teksti i plote i vendimit, vertetimi zyrtar se vendimi ka marre forme te prerë, ne qoftese nji gje e tille nuk del nga teksti i vete vendimit;

b) dokumenti nga i cili del se te paditurit, i cili nuk ka marre pjese ne gjykimin, i eshte derguar, me kohe dhe ne formen e duhur, qofte edhe nje here, njoftim per thirjen ne gjykate;

c) perkethimet e vertetuara te dokumentave, që përdoren ne pikat "a" dhe "b" te ketij neni, ne formen sipas pikes 2 te nenit 9 te kesaj Konvente.

#### Neni 47

Neqoftese me rastin e shqyrtimit te kerkeses per legjimin e ekzekutimit te detyrueshem gjykates i lindin dyshime, kjo mund te therese personin qe ka bere kerkesen, te kerkoje prej tij sqarime ose t'a detyroje qe te çduke te metat e kerkeses. Ajo mund te ftoje, gjithashtu, debitorin qe figuron ne kerkesa dhe te kerkoje sqarime nga gjykata qe ka dhene vendimin.

#### Neni 48

1.- Menyra e ekzekutimit te detyrueshem rregullohet nga legjislacioni i Pales Kontraktonjese, ne territorin e seciles duhet te behet ekzekutimi i detyrueshem.

2.- Debitori mund te beje ne gjykaten qe ka dhene vendim per lejimin e ekzekutimit te detyrueshem, kundërshtim si per lejimin e tij, ashtu dhe per kerkesat e pranuar me vendimin gjyqsor, vetem ne rast se nje gje e tille lejohet nga legjislacioni i Pales Kontraktonjese, ne territorin e seciles eshte dhene vendimi.

#### Neni 49

Per shpenzime gjyqsore, qe kane lidhje me ekzekuti-

min e detyrueshem, zbatohet legjislacioni i pales kontraktonjese, ne territorin e seciles vendimi duhet te vihete ne ekzekutim.

#### Neni 50

Refuzimi per njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqesore per ceshtje civile, familjare dhe te marteses

Njohja e vendimit gjyqesor ose lejimi i ekzekutimit te detyrueshem mund te refuzohet :

a) Neqoftese personi qe ka bere kerkesen, ose i padituri ne ceshtjen nuk ka marre pjese ne gjykimin per shkak se atij ose perfaqesuesit te tij nuk i qe bere me kohe ne formen e duhur thirja per ne gjykate, ose per shkak se thirja ishte bere vetem me ane shpallje publike ose me nje menyre qe nuk njihet nga dispozitat e kesaj Konvente;

b) neqoftese vendimi gjyqesor eshte ne kundërshtim me nje vendim të mepareshem, qe ka marre forme te prere, te dhene per ceshtjen midis po atyre paleve, per po ato objekte dhe per ate shkak nga gjykata e pales Kontraktonjese, ne territorin e seciles duhet te njihet vendimi ose te behet ekzekutimi i detyrueshem. Kjo dispozite nuk shtrihet per rastet kur kane ndryshuar ne menyre thelbesore, rrethanat, ne baze te se cilave jane percaktuar, nga vendimi i meparshem gjyqesor, permbajtja dhe koha e ekzekutimit.

#### Neni 51

##### Dispozite e perbashket

Dispozitat e neneve 44 - 50 te kesaj Konvente mbi vendimet gjyqesore zbatohen edhe per aktet e pajtimit te bera nga institucionet e drejtesise.

#### Kapitulli II

##### NDIHMA JURIDIKE PER ÇESHTJE PENALE

## Neni 52

## Detyrimi per dorzimin

1.- Palet Kontraktonjese detyrohen, ne baze te kerkeses, t'i dorzojne njera tjetres personat, qe ndodhen ne territorin e tyre per t'i marre nepergjegjisi penale ose per te mene ne ekzekutim vendimin penal.

2.- Dorzimi lejohet vetem per krime te atilla, kryerja e te cilave mund te sjelle me vehte, sipas legjislacionit te te dy Paleve Kontraktonjese, denime me burgim per nje kohe me te gjate se nje vit, ose nje denim me te rende (me tutje do te quhen "krime qe sjellin me vehte dorzimin").

## Neni 53

## Refuzimi per dorzim

Dorzimi nuk mund te behet ne qoftese:

- a) personi, dorzimi i te cilit kerkohet, eshte shtetas i Paleve Kontraktonjese, se ciles i eshte drejtuar kerkesa;
- b) krimi eshte kryer ne territorin e Paleve Kontraktonjese se ciles i eshte drejtuar kerkesa;
- c) ndjekjet penale, sipas legjislacionit te Paleve Kontraktonjese, se ciles i eshte drejtuar kerkesa, nuk mund te fillojne ose vendimi penal nuk mund te vihet ne ekzekutim per shkak te kalimit te afatit te parashkrimit ose per ndonji shkak tjeter ligjor;
- ç) ndjekjet penale hyjne ne kompetencen vetem te institucionit te drejtesise te Paleve Kontraktonjese, te ciles i eshte drejtuar kerkesa ;
- d) ndaj personit, dorzimi i te cilit kerkohet, eshte dhene, ne territorin e paleve Kontraktonjese, se ciles i eshte drejtuar kerkesa, nje vendim penal po per ate krim, ose eshte vendosur pushimi i çeshtjes me vendim qe ka marre forme te prere.

## Neni 54

## Detyrimi per te filluar ndjekje penale

1.- Secila Pale Kontraktonjese detyrohet, ne baze te kerkeses se Pales tjeter Kontraktonjese, te filloje, ne perputhje me legjislacionin e saj, ndjekje penale kunder shtetasve te saj qe dyshohen se kane kryer ne Territorin e Pales tjeter Kontraktonjese krim qe sjelle me vehte dorzimin.

2.- Kerkeses i bashkangjitet dokumentacioni, qe permban te dhena ne lidhje me krimin, dhe te gjitha provat qe ka rreth krimit

3.- Pala Kontraktonjese, seciles i drejtohet kerkesa, njofton Palen Kontraktonjese qe ka bere kerkesen, per rezultatet nga gjykimi penal, dhe, ne rast se eshte dhene vendimi penal qe ka marre forme te prere i dergon kopjen e vendimi penal.

## Neni 55

## Menyra e komunikimit

Per ceshtjet e dorzimit dhe te fillimit te ndjekjeve penale komunikojne me njera tjetren Ministrija e Drejtesise ose Prokuroria e Republikes Popullore te Shqiperise dhe Prokuroria e Bashkimit te Republikave Socialiste Sovjetike.

## Neni 56

## Kerkesa per dorzim

Kerkeses per dorzim i bashkangjiten:

a) origjinali ose kopja e vertetuar e vendimit per arrestim, dhe, kerkeses per dorzim per venejen ne ekzekutim te vendimit penal, origjinali ose kopja e vertetuar e vendimit penal qe ka marre forme te prere; keto dokumenta duhet te permbajne te dhena ne lidhje me figuren e krimit, sidomos me vendin dhe kohen e kryerjes se krimit dhe mbi cilesimin e tij juridik; neqoftese nga krimi eshte



shkaktuar dem material, duhet te tregohet edhe masa e tij;

b) Teksti i ligjes se Pales Kontraktonjese qe ka bere kerkesen, ne baze te te cilit cilesohet krim;

c) Te dhena ne lidhje me masen e denimit te pavuajtur, ne rast kerkesese per dorzim te nje personi te denuar, i cili ka vuajtur nje pjese te denimit;

ç) Te dhenat ne lidhje me shtetesin e personit, dorezimi i te cilit kerkohet, dokumentat dhe informatat per vend banimin ose vend qendrimin e tij dhe te dhenat per personin e tij, kur ka te tilla, si dhe pershkrimi i jashtem, fotografit dhe shenjat e gishta-ve.

#### Neni 57

##### Informata plotesuese

1.- Ne qofte se lind dyshimi ne se krimi qe sjelle me vete dorezimin eshte kryer, ose ne qofte se kerkesa per dorzim nuk permban te gjitha te dhenat e nevojeshme, pala kontraktonjese, se ciles i drejtohet kerkesa, mund te kerkoje informata plotesuese, dhe per kete, cakton nje afat nga nje gjer ne dy muaj. Ky afat mund te zgjatet, kur ka shkaqe te arsyeshme, ne baze te kerkeses se Pales Kontraktonjese qe ben kerkesen.

2.- Neqoftese pala Kontraktonjese qe ben kerkesen, nuk paraqit, ne afatin e caktuar, informata plotesuese, Pala Kontraktonjese, se ciles i drejtohet kerkesa, mund t'a liroje personin e mbajtur ne arrestim.

#### Neni 58

##### Mbajtja ne arrestim per dorezim

Me marrjen e kerkeses, Pala Kontraktonjese, se ciles i esht bere kerkesa, merr me nje here masa per mbajtien ne arrestim te personit, dorezimi i te cilit kerkohet, me perjashtim te rasteve kur

dorezimi nuk mund te behet.

### Neni 59

#### Mbajtia ne arrestim para marrjes se kerkeses per dorezim

1.-Personi, per arrestimin e te cilit eshte bere kerkesa, mund te mbahet ne arrestim para marrjes se kerkeses per dorezim. Kerkesa duhet te permbaje vendimin mbi mbajtien ne arrestim ose vendimin penal, qe ka marre forme te prere, dhe shenimin se kerkesa per dorezim do te paraqitet veçanerisht, kerkesa permbajtien ne arrestim gjer ne marrjen e kerkeses per dorezim, mund te behet me poste, telegram, telefon ose radio.

2.- Kur ka dyshime te bazuara se nje person ka kryer ne teritorin e Palese tjeter Kontraktonjese krim qe sjelle me vehte dorezimin, ky mund te mbahet ne arrestim pa kerkesa, te parashikuar nga pika 1 e ketij neni.

3.-Per mbajtien ne arrestim ,gjer ne marrjen e kerkeses per dorezim, duhet te njoftohet me nje here Pala Kontraktonjese.

### Neni 60

#### Lirimi ngarrestimi ne rast mos ardhjeje te kerkeses per dorezim

1.-Personi i mbajtur ne arestim si pas pikes 1 te nenit 59 te kesaj Konvente, mund te lirohet ne qoftese gjate dy muajve nga dita e dergimit te njoftimit per arestim nuk ka ardhur kerkesa per dorzim.

2.-Personi, i mbajtur ne arestim si pas pikes 2 te nenit 59 te kesaj Konvente, mund te lirohet ne qoftese gjate nje muaji nga dita e dergimit te njoftimit per arestim nuk ka ardhur kerkesa per dorzim.

## Neni 61

## Shtytja e dorzimit

Ne qoftese personi, dorezimi i te cilit kerkohet, eshte marre ne pergjegjesi penale ose eshte denuar per nje krim tjeter ne teritorin e Pales Kontraktonjese, se ciles i eshte drejtuar kerkesa atehere dorezimi mund te shtyhet gjer sa te pushojn ndjekjet penale, ose gjersa te vihet ne ekzekutim vendimi penal, ose gjersa te lirohet nga denimi.

## Neni 62

## Dorezimi me kohe

1.-Ne qofte se shtytja e dorezimit, parashikuar nga neni 61 i kesaj Konvente, mund te sjelle me vehte kalimin e afatit te parashikimit te ndiekieve penale ose ta shkaktoje dem te math hettimit te krimit, personi, dorezimi i te cilit kerkohet, mund te dorezohet me kohe, ne baze te nje kerkese te bazuar.

2.-Personi i dorzuar me koh duhet te kethehet pas kryerjes se atij veprimi ne lidhje me qeshtjen penale, per te cilen ai u dorrezua.

## Neni 63

## Konflikti midis kerkesave per dorzim

Ne qoftese kerkesa per dorzim behen nga disa shtete, Pala kontraktonjese, se ciles i jane dorezuar kerkesat, vendos se cila nga keto kerkesa duhet pranuar.

## Neni 64

Kufijte e ndiekieve kunder personit te dorzuar

1.-Pa pelqimin e pales Kontraktonjese, se ciles i eshte

drejtuar kërkesa, personi i dorezuar nuk mund të merret në përgjegjësi penale, të vuajë dënimin ose t'i dorëzohet një shteti të tretë për shkak se para dorëzimit ka kryer një krim për të cilin ai nuk u dorëzua.

2.- Pëlqimi nuk kërkohet në qoftesë mbrenda një muaji pas përfundimit të procesit penal, dhe, në rast dënimi, mbrenda një muaji pas vuajtjes së dënimit ose lirimit prej tij, personi i dorezuar nuk le tëritorin e Pales Kontraktgjese që ka bërë kërkesën, ose kethehet ketu. Në këtë afat nuk llogaritet koha gjatë së cilës personi i dorezuar jo për fajin e tij, nuk ka mundur të lere tëritorin e Pales Kontraktgjese që ka bërë kërkesën.

#### Neni 65

##### Dorzimi

Pala Kontraktgjese, së cilës i është drejtuar kërkesa, njofton Palen tjetër, që ka bërë kërkesën, në lidhje me vendin dhe kohën e dorëzimit. Në qoftesë Pala Kontraktgjese, që ka bërë kërkesën nuk e mer personin, që duhet të dorëzohet, mbrenda një muaji pas caktimit të datës së dorëzimit, ky person mund të lirohet nga arrestimi.

#### Neni 66

##### Dorzimi rishtas

Në qoftesë personi i dorezuar u shmanget ndiekieve penale dhe kethehet në tëritorin e Pales Kontraktgjese së cilës i është drejtuar kërkesa, ky, në bazë të kërkesës së re duhet të dorëzohet, pa u paraqitur materialet që përmenden në nenet 56 dhe 57 të kësaj Konvente.

#### Neni 67

##### Njoftimi i përfundimit të ndiekieve penale

Palet Kontraktgjese i njoftojnë njëra tjetres përfundimin e ndiekieve penale kundër personit të dorëzuar prej tyre. Në qoftesë kundër këtij personi është dhënë një dënim penal, pas marrjes së tij forme të prërë dërgohet kopja e tij.

## Neni 68

## Kalimi tranzit

1.-Pala Kontraktonjëse, ne baze te kerkeses, lejon kalimin tranzit ne teritorin e saje te personave qe i dorezohen Pales tjeter kontraktonjese nga nje shtet i trete.

2.-Kerkesa per lejimin e nje kalimi te tille jepet dhe shqyrtohet po ne ate menyre sikurse eshte kerkesa per dorezim.

3.-Palet Kontraktonjese nuk jane te detyruar te lejojne kalimin e personave, dorezimi i te cileve nuk mund te behet si pas kesaj Konvente.

## Neni 69

## Dorezimi i personave te ndodhur ne arestim

1.-Ne qoftese lind nevoja per te pyetur si deshmitar persona qe ndodhen ne arestim ne teritorin e Pales tjeter Kontraktonjese, organet, qe permenden ne nenin 55 te kesaj Konvente, mund te japin urdher qe keta t'i dorezohen Pales Kontraktonjese qe ka bere kerkesen me kusht qe te mbahet ne arrestim dhe te kethehen sa me shpejt pas pyetjes.

2.-Ne qoftese lind nevoja per te pyetur si deshmitar personat qe ndodhen ne arrestim ne nje shtet te trete, organet e Pales Kontraktonjese qe permenden ne nenin 55 te kesaj Konvente, te cilave u eshte drejtuar kerkesa, lejojne kalimin e ketyre personave nepermjet teritorit te shtetit te tyre, duke respektuar dispozita e nenit 8 te kesaj konvente.

## Neni 70

## Dorezimi i sendeve

1.-Palet kontraktonjese detyrohen t'i dorezojne njera tjetres :

a) Sendet qe jane fituar me ane krimi qe sjelle me vehte dorezimin, ose vleften e tyre;

b) Sendet që mund të kenë rendesi si prova në çështje penale, këto sende dorëzohen, edhe kur dorëzimi i fajtorit nuk mund të bëhet për shkak të vdekjes, arratisjes së tij ose për shkak të rrethanave të tjera.

2.-Në qoftëse Pala Kontraktuese, se ciles i është drejtuar kërkesa, i nevojiten sendet, për të cilat është bërë kërkesa, si prova në çështjen penale, dorëzimi i tyre mund të shtyhet gjër në perfundimin e çështjes.

3.-Të drejtat e personave të tretë mbi sendet e dorëzuara mbeten në fuqi. Pas perfundimit të çështjes këto sende duhet t'i kthehen pa shperblim Pales Kontraktuese që i ka dorëzuar.

#### Neni 71

##### Refuzimi i ndihmes juridike për çështje penale

Ndihma juridike për çështje penale nuk jepet në qoftëse :

a) Kërkohet ndihme juridike për vepra të cilat sipas legjislacionit të Pales Kontraktuese se ciles i është drejtuar kërkesa, nuk janë penalisht të dënueshme;

b) Kërkohet ndihme juridike për krime që nuk sjellin me vete dorëzimin.

#### Neni 72

##### Njoftimi mbi vendimet penale me dënim

Palet kontraktuese do t'i japin çdo vit njëra të tretes informata për vendimet penale që kanë marrë formë të prera, të dhëna nga gjykatat e një Pale Kontraktuese kundër shtetasve të Pales tjetër Kontraktuese, duke marrë njëkohsisht masa për dërgimin e shenjave egzistente të gishterve të personave të dënuar.

Pjesa III  
DISPOZITA TE FUNDIT  
Neni 73  
Ratifikimi

Kjo Konvente duhet te ratifikohet. Shkembimi i instrumentave te ratifikimit do te behen ne nje kohe sa me te afert ne Tirane.

Neni 74

Hyrja ne fuqi

1.- Kjo Konvente hyn ne fuqi me kalimin e nje muaji nga dita e shkembimit te instrumentave te ratifikimit. Konventa do te jete ne fuqi per pese vjet nga dita e hyrjes se saje ne fuqi.

2.- Ne qofte se asnje nga Palet Kontraktonjese nuk njofton te paktën gjashte muaj me pare nga mbarimi i afatit te permendur pese vjeçar se heq dore nga kjo Konvente, fuqija e saj zgjatet per nje kohe te pacaktuar dhe Konventa do te mbetet ne fuqi gjersa njerëra nga Palet Kontraktonjese t'a denoncoje, duke paralajmeruar per kete nje vit me pare.

Neni 75

Tekste autentike

Kjo Konvente u perpilua ne dy kopje, ne gjuhen shqip dhe ruse, dhe te dy tekstet kane te njejten fuqi.

Per vertetim sa me siper, te Plotfuqishmit e te dy Paleve Kontraktonjese e neneshkruan kete Konvente dhe e vulosen me vulat e tyre.

Bere ne Moske me 30 Qershor 1958

ME AUTORIZIMIN E PRESIDIUMIT TE  
KUVENDIT POPULLOR TE REPUBLIKES  
POPULLOR TE SHQIPERISE

ME AUTORIZIMIN E PRESIDIUMIT TE  
SOVJETIT SUPREM TE BASHKIMIT TE  
REPUBLIKAVE SOCIALISTE SOVJETIKE




